



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.35

2 prill

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Rezolutë e Kuvendit datë 21.3.2007	Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2006	661
Rregullore e Ministrit të Mbrojtjes nr. 315, datë 15.3.2007	Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejeve të importimit, eksportimit dhe të prodhimit të lëndëve plasëse, të lëndëve piroteknike, fishekzjarrë, për përdorim civil, dhe funksionimit të Komisionit të dhënies së lejeve	662
Vendim i ERE nr. 17, datë 26.3.2007	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga “Emikel” sh.p.k. për vitin 2006	672
Vendim i ERE nr. 18, datë 26.3.2007	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Spahiu Gjanç” për licencim në aktivitetet e importit dhe eksportit të energjisë elektrike	672

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT
PËR VITIN 2006

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, pasi dëgjoji Raportin për Veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2006, **konstaton se:**

- Veprimtaria e Kontrollit të Lartë të Shtetit është ushtruar në përputhje me kërkesat e nenit 164 të ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 1.6.2000.

- Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rritur kontributin e tij në drejtëm të përmirësimit të administrimit të financave publike.

Kuvendi vlerëson se Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përmirësuar veprimtarinë në drejtëm të:

- Përdorimit racional të fuqisë kontrolluese dhe rritjes së efektivitetit të saj, duke e përqendruar atë në subjektet me peshë më të madhe në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, më problematike dhe me risk më të madh.

- Koordinimit të formave të ndryshme të kontrollit, duke i dhënë përparësi zhvillimit të kontrollit vlerësues të veprimtarisë së institucioneve, ndaj kontrollit të ligjshmërisë, rregullshmërisë e atij financiar.

- Përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë kontrolluese, nëpërmjet rritjes së profesionalizmit e pavarësisë së kontrollorëve, përmirësimit të procedurave administrative për sigurimin e cilësisë së punës kontrolluese, si dhe mbështetjes së kësaj veprimtarie në standardet kombëtare e ndërkombëtare të kontrollit.

- Përmirësimit të metodologjisë së kontrollit, duke synuar harmonizimin e standardeve të brendshme dhe dokumenteve të tjera të veprimtarisë kontrolluese me metodologjinë e kontrollit të institucioneve homologe të kontrollit në vende të tjera të BE-së.

- Shtimit dhe përmirësimit cilësor të përmbajtjes së masave të rekomanduara ndaj subjekteve të kontrolluara, si dhe përmirësimit të procedurave administrative për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij gjatë kontrolleve të ushtruara në këto subjekte.

- Dhënies së rekomandimeve ndaj institucioneve kompetente për plotësimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore.

- Përdorimit me efektivitet dhe në përputhje me ligjin të fondeve buxhetore të institucionit.

- Zgjerimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet kombëtare, organizmat ndërkombëtarë të kontrollit dhe institucionet homologe në vende të ndryshme të BE-së.

Kuvendi kërkon që për vitin 2007 Kontrolli i Lartë i Shtetit të thellojë më tej përvojën e fituar gjatë vitit 2006 e gjatë gjithë veprimtarisë së tij, në këto drejtime:

- Forcimin e mëtejshëm organizativ të institucionit, si dhe përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, në përputhje me ritmin dhe dinamikën e zhvillimit të vendit, për t’iu përgjigjur detyrimeve që rrjedhin nga objektivat për t’u integruar në BE dhe NATO.

- Fuqizimin e veprimtarisë kontrolluese, veçanërisht në përdorimin e fondeve të marra hua nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe të financimeve nga donatorë të huaj për investime, duke shfrytëzuar përvojën e institucioneve homologe të kontrollit në vende të tjera.

- Rritjen e bashkëpunimit me subjektet e kontrolluara për zbatimin e rekomandimeve, si dhe të bashkëpunimit me njësitë e kontrollit të brendshëm, për të shmangur mbivendosjet në kontroll dhe për të rritur efektivitetin e veprimtarisë kontrolluese, në përputhje me ligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- Rritjen e bashkëpunimit me Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht për hartimin e ligjit të ri për financimet e huaja, përmirësimin e legjislacionit të sistemit tatimor dhe të ligjit për urbanistikën.

Kuvendi e konsideron të drejtë kërkesën e Kontrollit të Lartë të Shtetit për shtimin e numrit të punonjësve dhe të burimeve financiare, me qëllim zgjerimin e veprimtarisë kontrolluese mbi përdorimin e fondeve buxhetore në bashkitë dhe komunat. Këtë kërkesë Kuvendi do ta shqyrtojë gjatë diskutimit të amendamenteve në ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007 dhe të projektbuxhetit të vitit 2008.

Kuvendi i sugjeron Këshillit të Ministrave të shqyrtojë rekomandimet e Kontrollit të Lartë

të Shtetit për përmirësimin e legjislacionit, t'u kërkojë institucioneve shtetërore në varësi të tij rritjen e shkallës së zbatimit të masave disiplinore e administrative të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe të rrisë rolin dhe autoritetin e njësive të kontrollit të brendshëm.

Kuvendi i kërkon Prokurorisë së Përgjithshme të kryejë deri në fund proceset hetimore për paditë penale të paraqitura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për të vënë para përgjegjësisë ligjore personat përgjegjës për shkelje të ligjit.

21 mars 2007

RREGULLORE **Nr.315, datë 15.3.2007**

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LEJEVE TË IMPORTIMIT, EKSPORTIMIT DHE TË PRODHIMIT TË LËNDËVE PLASËSE, TË LËNDËVE PIROTEKNIKE, FISHEKZJARRË, PËR PËRDORIM CIVIL DHE FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË DHËNIES SË LEJEVE

Mbështetur në nenin 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në bazë e zbatim të ligjit nr.9126, datë 29.7.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr.597, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për procedurën për dhënien e lejes së importimit, eksportimit dhe të prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil”, dhe vendimit nr.853, datë 17.12.2004 të Këshillit të Ministrave “Për procedurën e dhënies së lejes së importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarrë, për përdorim civil”,

Ministri i Mbrojtjes nxjerr këtë rregullore:

KREU I **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti dhe fusha e veprimit të rregullores

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave, rregullave dhe i përgjegjësisë të administratës shtetërore dhe aplikantëve për marrjen e lejes për importin, eksportin dhe prodhimin e lëndëve plasëse, lëndëve piroteknike e fishekzjarrë, për përdorim civil dhe funksionimi i Komisionit sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe këtë rregullore për dhënien e lejeve të lëndëve plasëse, piroteknike e fishekzjarrë, për përdorim civil në Republikën e Shqipërisë.

2. Kjo rregullore zbatohet nga Komisioni i dhënies së lejeve dhe të gjithë personat fizikë ose juridikë, që kërkojnë leje për importin, eksportin dhe prodhimin e lëndëve plasëse, lëndëve piroteknike e fishekzjarrë, për përdorim civil.

3. Kjo rregullore nuk zbatohet për lëndët plasëse, piroteknike fishekzjarrë, që përdoren nga Forcat e Armatosura dhe ato nën juridiksionin e Ministrisë së Brendshme, përdorimi i të cilave rregullohet me ligj të veçantë.

4. Rregullorja përcakton organizimin dhe funksionimin e strukturave që merren me procedurat e dhënies së lejeve.

5. Rregullorja bën klasifikimin e lejeve, kushtet dhe kriteret që duhen plotësuar për t'u pajisur me njërën apo më shumë nga llojet e lejeve, si dhe është bazë për funksionimin e komisionit të dhënies së lejeve në Ministrinë e Mbrojtjes dhe e detyrueshme për t'u zbatuar nga subjektet që kërkojnë leje pranë këtij komisioni.

KREU II **ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT PËR DHËNIEN E LEJEVE**

Neni 2 **Krijimi, përbërja**

Komisioni i dhënies së lejeve për importin, eksportin dhe prodhimin e lëndëve plasëse, lëndëve piroteknike e fishekszarrë (më poshtë si komisioni i lejeve apo komisioni) për përdorim civil përbëhet nga:

- | | |
|---|------------|
| 1. Drejtori i Instalimeve dhe Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes | kryetar |
| 2. Përgjegjës i sektorit të ligjeve në DHLMK | nënkryetar |
| 3. Specialist DIMBb (inxhinier/ekonomist) | anëtar |
| 4. Specialist i municioneve konvencionale (Sek.A-M) | anëtar |
| 5. Specialist i municioneve xheniere (Sek.A-M) | anëtar |

Sekretari teknik i komisionit caktohet nga kryetari i Komisionit, specialisti i municioneve xheniere në sektorin e armatim-municionit të Drejtorisë së Logjistikës dhe në mungesë të këtij funksioni organik ose për mosplotësim të tij, një specialist i municioneve në sektorin e armatim-municionit të Drejtorisë së Logjistikës.

Komisioni ushtron veprimtari në përputhje me këtë rregullore, aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që përcaktojnë kriteret në këtë fushë.

Neni 3 **Mbledhjet e Komisionit**

1. Komisioni thirret në mbledhje nga kryetari i Komisionit brenda 10 ditëve nga ardhja e kërkesës për pajisje me leje nga ndonjë subjekt fizik ose juridik.

2. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se gjysma e numrit të anëtarëve të Komisionit.

- Në mungesë të kryetarit, të gjitha funksionet kryhen nga nënkryetari i Komisionit.

3. Në mbledhjet e radhës Komisioni shqyrton dhe vendos për kërkesat, ankesat, informacionet e paraqitura pranë Komisionit.

4. Mbledhjet e Komisionit janë të mbyllura dhe për to mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje dhe sekretari teknik.

Neni 4 **Përgatitja e materialeve për Komisionin**

1. Rendi i ditës për mbledhjen e radhës të Komisionit hartohet nga sekretari i Komisionit dhe miratohet nga kryetari i Komisionit, i cili cakton orën dhe datën e mbledhjes, ndërsa sekretari njofton anëtarët e Komisionit dhe u vë në dispozicion dosjen e përgatitur për kërkesën e ardhur nga subjekti.

2. Komisioni shqyrton materiale që kanë të bëjnë me lejet për subjektet aplikuese, ankesa të tyre, informacione e kërkesa të organeve të administratës publike ose komunitetit, përfundime nga kontrollet e kryera etj.

3. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u shpërndahen pjesëtarëve të Komisionit nga sekretari i tij jo më vonë se dy ditë para ditës së caktuar për mbledhje.

Neni 5 **Ekspertët**

1. Për çështje që do të shqyrtohen, të cilat kanë nevojë për verifikim dhe informacion të mëtejshëm, caktohen ekspertë. Çdo grup ekspertësh drejtohet nga një anëtar Komisioni.

2. Ekspertët përzgjidhen nga kryetari i Komisionit me propozim të anëtarëve të Komisionit në varësi të problematikës.

3. Ekspertiza e përgatitur me shkrim dorëzohet në Komision. Ekspertët për punën e kryer mund të shpërblehen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes. Palët bien dakord për termat e pagesës.

Neni 6 **Marrja e vendimeve**

1. Komisioni merr vendim jo më vonë se 20 ditë nga ardhja e kërkesës nga subjekti me dokumentacionin përkatës të protokolluar në sekretari dhe i kthen përgjigje subjektit zyrtarisht brenda 30 ditëve dhe brenda afateve të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, për kërkesa e ankesa të tjera.

- Këto afate fillojnë nga data e plotësimit të plotë të dokumentacionit sipas kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Leja e importimit, eksportimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, jepet brenda 30 ditëve nga data e aplikimit me shkrim të kërkuarit, ndërsa leja e prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, jepet brenda 6 muajve nga data e aplikimit të kërkuarit.

3. Leja e importit dhe eksportit të lëndëve piroteknike, fishekzjarrë, për përdorim civil, jepet brenda 30 ditëve nga data e aplikimit me shkrim të kërkuarit, ndërsa leja e prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarrë, për përdorim civil, jepet brenda 6 muajve nga data e aplikimit të kërkuarit.

4. Për subjektet fizike e juridike vendase ose të huaja që kërkojnë/kanë leje prodhimi, Komisioni ka të drejtë të ushtrojë kontroll në linjat e prodhimit, si dhe në dokumentacionin e tyre për këtë lloj aktiviteti sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë si në fazën e shqyrtimit të kërkesës për leje prodhimi, ashtu edhe gjatë testimit të prodhimit dhe pas dhënies së lejes së prodhimit.

Neni 7 **Vendimet**

1. Komisioni merr vendim për dhënien, revokimin, ndryshimin e lejeve, si dhe për çdo çështje të ngritur para tij. Komisioni shprehet me vendime për çështjet e ngritura para tij.

2. Vendimet në Komision si rregull merren me shumicën e votave të pjesëmarrësve.

- Në rastet kur votimi rezulton i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

3. Vendimet e Komisionit zbardhen nën përgjegjësinë e sekretarit të tij, nënshkruhen nga kryetari dhe pjesëtarët e Komisionit që kanë qenë pjesëmarrës në mbledhje.

4. Vendimet e Komisionit përgatiten në 2 kopje dhe ruhen një në sekretarinë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe një në dosjen përkatëse të çdo subjekti.

Neni 8 **Shpërblimi i Komisionit**

1. Puna e kryer nga anëtarët e Komisionit dhe e punonjësve të tjerë që lidhen me këtë proces shpërblehet.

2. Anëtarët e Komisionit, pjesëmarrës në mbledhje dhe sekretari teknik shpërblehen me 5000 lekë. Listëprezenca hartohet nga sekretari i Komisionit dhe nënshkruhet nga kryetari i tij.

3. Drejtorja e Administratës dhe Shërbimeve bën pagesën brenda 5 ditëve nga dërgimi i listëprezencës nga kryetari i Komisionit.

Neni 9 **Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave**

1. Kërkesa për leje dhe dokumentacioni përkatës bashkëngjitur dërgohen zyrtarisht të protokolluara nga subjektet dhe të mbyllura në zarfin përkatës.

- Dokumentet për licencë duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

- Në faqen e jashtme të zarfit që mban adresën e plotë të subjektit kërkuar, nënshkrimin dhe vulën e tij, shkruhet adresa e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe shënimi sipas rastit “dokumente për leje importi, eksporti, prodhimi lëndësh plasëse, piroteknike apo fishekzjarrë për përdorim civil”.

2. Kërkesa e protokolluar pasi konsiderohet nga kryetari i Komisionit i adresohet sekretarit të Komisionit, i cili për çdo subjekt hap një dosje të veçantë dhe e ruan atë për një vit kalendarik pastaj e dorëzon në sekretarinë e Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 10

Shqyrtimi i kërkesave

Çdo kërkesë e ardhur:

- i nënshtrohet opionencës së anëtarëve të Komisionit nëse ajo është në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore;
- shoqërohet detyrimisht me mendimin e motivuar e të nënshkruar të specialistit në kartelën shoqëruese të kërkesës.

Neni 11

Ruajtja dhe arkivimi

1. Sekretari teknik përgatit lejet në bazë të vendimit të Komisionit në 4 kopje: 1 subjektit kërkuar kundrejt pagesës, 1 në dosjen e subjektit, 1 në sekretarinë e Ministrisë së Mbrojtjes, 1 në llogarinë e armatim-municionit të Drejtorisë së Logjistikës për regjistrim të lëndëve plasëse në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse (kjo vetëm për lëndët plasëse dhe jo për lëndët piroteknike).

2. Lejet janë dokumente zyrtare që i nënshtrohen prodhimit të posaçëm dhe kontrollit të rreptë. Format i tyre propozohet nga Komisioni dhe miratohet nga Ministri i Mbrojtjes.

3. Sekretari teknik përgjigjet për arkivimin sipas rregullave në fuqi të lejes, dokumentacionit, kërkesës dhe mandatit të arkëtimit për pagesën sipas tarifës përkatëse.

Neni 12

Tarifat

Tarifat për lejet përcaktohen në akte të tjera nënligjore.

Leja e miratuar nuk jepet nëse aplikuesi nuk ka paguar brenda një afati prej 15 ditësh nga marrja e njoftimit të miratimit në parim të lejes, tarifën financiare për lëshimin e lejes me urdhër derdhjeje në bankë për llogari të repartit ushtarak nr.6000 (Ministria e Mbrojtjes) Tiranë.

Neni 13

Komunikimi me subjektet

1. Sekretari i Komisionit komunikon sipas rregullit të brendshëm të Ministrisë, me subjektet e interesuara, argumenton refuzimin pjesor ose të plotë të kërkesës dhe jep sqarimet e nevojshme në zbatim të kësaj rregulloreje.

2. Shpërndarja e lejeve të interesuarve bëhet dorazi nga sekretari i Komisionit brenda 5 ditësh nga zbardhja e lejes.

3. Komisioni kërkon ndaj subjekteve aplikuese respektimin e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe kjo rregullore.

Neni 14

Bashkëpunimi me administratën publike

Komisioni bashkëpunon me institucionet përgjegjëse dhe të interesuara për zbatimin e legjislacionit në fuqi në lidhje me këtë rregullore. Ai:

- kërkon, pranon dhe u jep atyre zyrtarisht informacion për subjektet që licencohen pranë tij;
- trajton dhe u kthen zyrtarisht përgjigje ankesave të tyre.

Neni 15

Veprime drejtpërdrejt nga sekretari teknik

1. Sekretari teknik ka të drejtë të kryejë çdo ditë veprime, pa kaluar në Komision, për rastet e shënuara më poshtë, mbështetur në dokumentacionin përkatës të paraqitur në zbatim të kësaj rregulloreje.

Sekretari teknik komunikon me subjektet kërkuuese:

- për plotësim dokumentacioni sipas kërkesave të ligjit;
- për dhënie, pranim dokumentesh, faturash bankare dhe për sqarime të tjera;
- për shpjegimin e legjislacionit subjekteve që kanë aplikuar për leje.

Neni 16

Paraqitja, protokoli, regjistrat, arkivi

1. Çdo kërkesë dhe dokumentacion shoqërues sipas kësaj rregulloreje duhet të jetë në gjuhën shqipe (dokumentet e përkthetra noterizohen).
2. Çdo dokument i fotokopjuar duhet të jetë i noterizuar.
3. Sekretari teknik mban dhe ruan sipas rregullave në fuqi:
 - protokoll për evidentimin e kërkesave të subjekteve për licencim;
 - regjistër themeltar për lejet e lëshuara;
 - regjistër themeltar për korrespondencën.
4. Arkivi i sekretarit teknik, sipas mundësive, organizohet bashkë ose veças nga arkivi i Ministrisë, me urdhër të veçantë të titullarit.

KREU III

**LEJET, KLASIFIKIMI DHE KATEGORITË
KUSHTE DHE KRITERE NË PROCEDURAT E DHËNIES SË LEJES**

Neni 17

Leja

Leja është dokument ligjor e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar sipas klasifikimit të bërë në të, kushtet e kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi e në këtë rregullore.

Neni 18

Llojet e lejeve dhe elementet e saj

1. Llojet e lejeve janë:
 - leje importi lëndësh plasëse për përdorim civil;
 - leje eksporti lëndësh plasëse për përdorim civil;
 - leje prodhimi lëndësh plasëse për përdorim civil;
 - leje importi lëndësh piroteknike e fishekzjarrë për përdorim civil;
 - leje eksporti lëndësh piroteknike e fishekzjarrë për përdorim civil;
 - leje prodhimi lëndësh piroteknike e fishekzjarrë për përdorim civil.
2. Leja përmban këto elemente:
 - numrin e protokollit dhe datën e lëshimit;
 - emrin e subjektit të cilit i jepet (i plotë);
 - numrin dhe datën e vendimit të Komisionit për dhënien e lejes;
 - mënyrën e përdorimit të lejes, për import, eksport, prodhim me të drejtë tregtimi ose jo;
 - vendin nga do të importohet ose do të eksportohet apo ku do të përdoret për punime të ndryshme;
 - afatin e vlefshmërisë;
 - detyrimet që ka subjekti ndaj Komisionit;
 - ndryshimi i përqindjes së lagështisë në transport;
 - elemente të tjera specifike që Komisioni i gjykon të domosdoshme për raste të veçanta.
3. Në formë tablele leja duhet të përmbajë:
 - llojin e lëndës plasëse;
 - kodin e OKB-së;
 - sasinë e LP-së apo fishekzjarrë (copë, kg, ton, ml);
 - indeksin e uzinës prodhuese (për lëndët piroteknike);
 - çmimin;
 - vleftën financiare;
 - elemente të tjera specifike që Komisioni i gjykon të domosdoshme për raste të veçanta.

4. Lejet për lëndët plasëse për përdorim civil jepen vetëm për persona juridikë, ndërsa lejet për lëndë piroteknike e fishekzjarrë jepen për persona fizikë e juridikë.

Neni 19

Ndalimi i transferimit

1. Leja nuk lejohet të transferohet nga një person fizik a juridik te tjetri.
2. Kur një subjekt humbet lejen njofton menjëherë zyrtarisht komisionin e posaçëm dhe pajiset me dublikatë, me plotësimin e dokumenteve që konsiderohen të nevojshme nga Komisioni.
3. Lejet personale tërhiqen nga vetë aplikanti ose nga persona të autorizuar me akte noteriale për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit noterial depozitohet në dosjen që arkivohet).
4. Lejet e shoqërive tërhiqen domosdoshmërisht edhe në prani të drejtuesit apo drejtuesve teknikë.

Neni 20

Konflikti i interesave

Komisioni zbaton me rigozitet e nën përgjegjësi të plotë kërkesat e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Neni 21

Zëvendësimi

Në rast se një anëtar i Komisionit për shkaqe të arsyeshme nuk merr pjesë në mbledhjet e Komisionit për më shumë se tri herë radhazi dhe mungesa e tij ndikon në mbarëvajtjen e punës së Komisionit, drejtori përkatës (eprori i drejtpërdrejtë) apo personi i autorizuar prej tij caktojnë për periudhën vakante në vijim një nëpunës tjetër për të zëvendësuar nëpunësin që mungon.

Neni 22

Afatet e vlefshmërisë së licencës

1. Afatet e vlefshmërisë së lejeve nga data e lëshimit të tyre janë:
1 vit për:
 - leje importi lëndësh plasëse për përdorim civil;
 - leje eksporti lëndësh plasëse për përdorim civil;
 - leje importi lëndësh piroteknike fishekzjarrë për përdorim civil;
 - leje eksporti lëndësh piroteknike fishekzjarrë për përdorim civil.8 vjet për leje prodhimi lëndësh plasëse për përdorim civil.
5 vjet për leje prodhimi lëndësh piroteknike fishekzjarrë për përdorim civil.
2. Lejet e prodhimit të lëndëve plasëse dhe piroteknike e fishekzjarrë për përdorim civil mund të rinovohen. Procedurat e rinovimit janë të njëjta me ato të dhënies së lejes.

KREU IV

KUSHTET PËR TË MARRË LEJE

Neni 23

Dokumentet për leje importi të lëndëve plasëse

Subjekti i interesuar që kërkon të pajiset me leje për importim lëndësh plasëse, duhet të ketë këto dokumente:

- a) dokumentin e regjistrimit në gjykatë si person juridik;
- b) dokumentacionin e nevojshëm për llojet dhe sasinë e lëndëve plasëse nga uzinat prodhuese;
- c) dokumentin e vlerësimit të konformitetit dhe dokumentacionin me të dhënat teknike të përbërjes së lëndëve plasëse, të shoqëruara me fotografi;
- d) lejen nga Agjencia Rajonale e Mjedisit për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit;
- e) kontratën e shërbimit për ruajtjen fizike dhe transportimin me të tretë, kur nuk ka licencën

për këto shërbime;

f) lejen nga Ministria e Rendit Publik për magazinimin dhe transferimin e lëndëve plasëse, që do të përdoren gjatë punimeve;

g) kopje e lejes së mëparshme të importit (nëse ka), faturat dhe listën e lëndëve plasëse, që ka përdorur më parë, deklaratën për lëndët plasëse gjendje në depo dhe cilësinë e këtyre lëndëve.

Lëndët plasëse për përdorim civil importohen në Republikën e Shqipërisë vetëm pasi të jenë kontrolluar nga organi i autorizuar nga Ministri i Mbrojtjes, në bazë të procedurave të konformitetit.

Neni 24

Dokumentet për leje eksporti të lëndëve plasëse

Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me leje për eksport lëndësh plasëse, duhet të ketë këto dokumente:

- a) dokumentin e regjistrimit në gjykatë si person juridik;
- b) kopjen e kontratës së lidhur me subjektin përkatës, të shoqëruar me emërtimet, peshën bruto dhe neto;
- c) listën sipas emërtimeve me të dhënat teknike, të shoqëruara me fotografi, etiketat e përdorimit të vendosura nga uzina prodhuese;
- d) certifikatën e përdoruesit të fundit (END-USER-it).

Neni 25

Dokumentet për leje prodhimi të lëndëve plasëse

Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me leje për prodhim lëndësh plasëse, duhet të ketë këto dokumente:

- a) dokumentin e regjistrimit si person juridik;
- b) lejen nga Agjencia Rajonale e Mjedisit për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit;
- c) patentën e prodhimit me llojet e lëndëve plasëse, sipas vlerësimit të konformitetit (aneksi A, ligji nr.9126, datë 27.9.2003);
- d) projektin e ndërtimit të uzinës sipas standardeve që kërkon në rajonin ku do të vendoset kjo linjë;

Gjithashtu duhet të përmbushë edhe këto kritere:

- e) personeli inxhiniero-teknik (mekanikë, kimistë etj.) duhet të ketë përvojë pune në fushën e prodhimit të lëndëve plasëse jo më pak se 5 vjet;
- f) inxhinierët projektues duhet të kenë përvojë pune jo më pak se 3 vjet në këtë sektor dhe të kenë marrë pjesë në projektimin e jo më pak se 3 linjave teknologjike;

g) të ketë mjetet e nevojshme të transportit dhe të marrë masat për mbrojtjen nga zjarri, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 26

Leje për import të lëndëve piroteknike, fishekzjarrë

Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me leje për import të lëndëve piroteknike, fishekzjarrë, për përdorim civil, paraqet në Ministrinë e Mbrojtjes kërkesën me shkrim, në formë autobiografie, me adresën e saktë dhe dokumentet e mëposhtme:

- a) regjistrimin në gjykatë, si person juridik ose fizik, për import dhe tregtim fishekzjarrësh;
- b) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;
- c) certifikatën e numrit të identifikimit si person i tatueshëm;
- ç) listën e hartuar nga prodhuesi i fishekzjarrëve, me numrin e kodit, emërtimin e fishekzjarrëve, mënyrën e paketimit, sasinë, peshën, vlerën financiare, të përkthyer në shqip dhe të noterizuar;
- d) lejen e dhënë nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit;
- dh) lejen e dhënë nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi i qarkut për mjediset ku do të magazinohen fishekzjarrët;

e) kopjen e lejes së mëparshme të importit, në rast rinovimi;

Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Subjekti i interesuar, para zhdoganimit të fishekzjarrëve, bën në bankë një urdhër derdhjeje “Për likuidim detyrimi për marrjen e lejes së importit për fishekzjarrët”, për Ministrinë e Mbrojtjes.

Neni 27

Leje për eksport të lëndëve piroteknike, fishekzjarrë

Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me leje për eksport, të lëndëve piroteknike, fishekzjarrë, për përdorim civil, paraqet në Ministrinë e Mbrojtjes kërkesën me shkrim, në formë autobiografie me adresën e saktë dhe dokumentet e mëposhtme:

a) regjistrimin në gjykatë si person fizik ose juridik, për eksport dhe tregtim fishekzjarrësh;

b) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;

c) certifikatën e numrit të identifikimit si person i tatueshëm;

ç) listën e hartuar nga prodhuesi i fishekzjarrëve, me numrin e kodit, emërtimin e fishekzjarrëve, mënyrën e paketimit, sasinë, peshën, vlerën financiare, të përkthyer në shqip dhe të noterizuar, nëse është e nevojshme;

d) certifikatën e përdoruesit të fundit (END USER);

dh) urdhërderdhjen “Për likuidimin e detyrimit për marrjen e lejes së eksportit për fishekzjarrët”, për Ministrinë e Mbrojtjes.

Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Në rastet e mosdhënies së lejes së eksportit Ministria e Mbrojtjes i kthen subjektit shumën në lekë të derdhur për llogari të saj, sipas paragrafit të mësipërm.

Neni 28

Leje për prodhim të lëndëve piroteknike, fishekzjarrë

Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me leje, për prodhimin e lëndëve piroteknike, fishekzjarrë, për përdorim civil, paraqet në Ministrinë e Mbrojtjes kërkesën me shkrim, në formë autobiografie, me adresën e saktë dhe dokumentet e mëposhtme:

a) regjistrimin si person fizik ose juridik, për prodhim dhe tregtim fishekzjarrësh;

b) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;

c) certifikatën e numrit të identifikimit si person i tatueshëm;

ç) lejen e dhënë nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit;

d) patentën e prodhimit me llojet e fishekzjarrëve, sipas vlerësimit të konformitetit, në mbështetje të ligjit nr.9126, datë 27.9.2003;

dh) projektet e ndërtimit të uzinës, sipas standardeve, në rajonin ku do të vendoset linja e prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarrë, të siguruar dhe të miratuara në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) lejen e dhënë nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi e qarkut, për mjediset ku do të magazinohen fishekzjarrët.

Gjithashtu, subjekti duhet:

a) të ketë personel inxhiniero-teknik, mekanikë, kimistë me përvojë pune jo më pak se 5 vjet, në fushën e prodhimit të lëndëve plasëse dhe inxhinierë prodhimi me përvojë pune jo më pak se 3 vjet në këtë sektor, të cilët duhet të kenë marrë pjesë në projektimin dhe prodhimin e jo më pak se 3 linjave teknologjike;

b) të ketë siguruar mjetet e nevojshme të transportit dhe të ketë marrë masat e mbrojtjes nga zjarri, sipas legjislacionit në fuqi.

Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Subjekti i interesuar, para marrjes së lejes për prodhimin e fishekzjarrëve, bën në bankë një urdhër derdhjeje “Për likuidim detyrimi për marrjen e lejes së prodhimit të fishekzjarrëve”, për Ministrinë e Mbrojtjes.

KREU V

REGJISTRIMI I LEJEVE

Neni 29

Regjistrimi i lejeve

Leja regjistrohet në regjistrin themeltar duke pasqyruar edhe përmbajtjen e saj.

Regjistrimet duhet të jenë të sakta, të qarta, pa korrigjime, me vijueshmëri të numrit rendor dhe pa shkurtime.

Në regjistrin themeltar të regjistrimit nuk lejohet të fshihet asgjë.

Rregullimet bëhen me numër rendor të ri me fraksion.

Një kopje origjinale e lejes, së bashku me praktikën e sjellë nga kërkuesi, mbahet në arkivë pranë sekretarit teknik, dhe në fund të vitit dorëzohet në sektorin e arkiv-dokumentacionit të Ministrisë.

Regjistrimi i lejeve të lëndëve plasëse (jo piroteknike/fishekszjarrë) bëhet në regjistrin shtetëror që mbahen në Drejtorinë e Logjistikës.

KREU VI SANKSIONE

Neni 30

Masa ndëshkimore

Leja për lëndët plasëse për përdorim civil hiqet në rastet kur:

a) subjekti kryen vepër penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së importimit, eksportimit a prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil apo cenon jetën e shëndetin e njeriut;

b) personi fizik ose juridik, gjatë importimit, eksportimit apo prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, shkel rregullat teknike të prodhimit, transportit, përdorimit dhe të konformitetit të lëndëve plasëse, duke rrezikuar jetën e njerëzve e të kafshëve a mjedisin, si dhe kur nuk përmbush kriteret e përcaktuara.

Leja për lëndët piroteknike, fishekszjarrë, hiqet në rastet kur:

a) subjekti kryen vepër penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së importit, eksportit apo prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekszjarrë, për përdorim civil;

b) subjekti, gjatë importit, eksportit apo prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekszjarrë, për përdorim civil, shkel apo nuk plotëson rregullat teknike të prodhimit, përdorimit apo të konformitetit të lëndëve plasëse, duke rrezikuar mjedisin, jetën e njerëzve dhe të kafshëve, si dhe shkel kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

Për masat e marra njoftohet subjekti përkatës, institucionet e tjera shtetërore të interesuara dhe për rastet e deklarimeve të rreme, sanksionet ligjore për licencimin shoqërohen dhe me kallëzim në organet kompetente.

Neni 31

Përgjegjësitë e komisionerëve

Anëtarët e Komisionit mbajnë përgjegjësi disiplinore, administrative ose penale kur gjatë veprimtarisë së tyre për lëshimin e lejeve shkelin ose veprojnë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në këtë rregullore.

Neni 32

Ankimi

Personat e interesuar mund të ankohen kundër vendimeve të Komisionit, te Ministri i Mbrojtjes, në përputhje me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Titullari i Ministrisë, pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti, vendos:

- lënien në fuqi të vendimit të marrë nga Komisioni;
- anulon vendimin e marrë;
- kthen për rishqyrtim vendimin e marrë në Komision.

Çdo person juridik që ka paraqitur kërkesën pranë Komisionit të lejeve ose që ka marrë leje,

gëzon të drejtën e ankimit ndaj tij, kur ky Komision refuzon pranimin e kërkesës, nuk i miraton lëshimin e lejes ose i heq lejen për një ose më shumë aktivitete.

KREU VII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 33

Për çështje të cilat nuk gjejnë rregullim në këtë rregullore, Komisioni i referohet ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

Neni 34

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.17, datë 26.3.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT PËR
PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “EMIKEL”
SHPK PËR VITIN 2006**

Në mbështetje të neneve 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Emikel” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për vitin 2006

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë “Emikel” sh.p.k. për vitin 2006.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.18, datë 26.3.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“SPAHIU GJANÇ” PËR LICENCIM NË AKTIVITETET E IMPORTIT DHE EKSPORTIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 13 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2007, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Spahiu Gjanç” për licencime në aktivitetet e eksportit dhe të importit të energjisë elektrike

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Spahiu Gjanç” për licencime në aktivitetet e eksportit dhe të importit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 30.3.2007
Doli nga shtypi më 2.4.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë